



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution
Autoriteti Kompetent

AD.nr.16/2024

Datë: 12.12.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të avokatit B.A, i autorizuar i të dëmtuarit A.TH, kundër D.H, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 12.12.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore kundër D.H, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 05.12.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, nga ana e avokatit B.A, përfaqësues i autorizuari i palës A.TH, i cili në lëndën penale PP/I.nr., ka cilësinë e të dëmtuarit, kemi pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj prokurores D.H, ku në këtë kërkesë parashtuesi i saj pretendon se prokurorja D.H nuk kishte përmbushur obligimin në dhënien e shkresave të lëndës të autorizuarit të palës së dëmtuar, këtui parashtuesit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, av.B.A, duke kërkuar nga i njëjti autorizimin për përfaqësim të të dëmtuarit edhe pse autorizimi verbalisht ishte dhënë në seancën e shqyrtimit fillestar, ku me këtë mosveprim të prokurores, parashtuesi i kërkesës pretendon se pala e dëmtuar rrezikon humbjen e afatit për kundërshtimin e kërkesës për hushje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave të paraqitura nga pala e pandehur, me çka pretendon se prokurorja D.H ka kryer shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 1, nënpar.1.3 dhe paragrafi 2, nënpar.2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurores D.H.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Me datë 05.12.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nën numrin AD.nr.16/2024.

Me datë 05.12.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimit e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Me datë 18.10.2023, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës, Njësia e Hetimeve të Stacionit Policor NJHP, me numër të rastit ... të datës 17.10.2023, kundër të dyshuarit Y.B, në drejtim të veprës penale Vjedhja grabitqare nga neni 316 i KPRK-së. Më datë 13.12.2023, prokurorja e çështjes ka marrë aktvendimin për fillim të hetimeve kundër të pandehurit Y.B me dyshimin e arsyeshem se i njëjti së bashku me NN personat, kishte për të kryer veprën penale Vjedhja grabitqare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Pas zbatimit të procedurës hetimore dhe grumbullimit të provave, e me krijim të dyshimit të bazuar mirë se është kryer vepra penale, më datë 16.01.2024 është ngritur Aktakuza PP/I.nr... kundër të akuzuarit Y.B, i cili në bashkëkryerje me personat NN kanë kryer veprën penale Vjedhja grabitqare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke e dërguar çështje pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentin për Krime të Rënda. Më datë 22.11.2024, Gjykata Themelore në Prishtinë ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën ka prezantuar prokurorja e shtetit F.C, i akuzuari Y.B me mbrojtësin e tij av.F.K si dhe i dëmtuari A.TH me përfaqësuesin e tij av.B.A. Në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata ka marrë aktvendim përmes së cilit e ka obliguar Prokurorinë që në afat prej tre (3) ditësh të pajisë me të gjitha shkresat e lëndës të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij av.F.K si dhe të dëmtuarin me përfaqësuesin e tij av.B.A si dhe ka njoftuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij që deri më datë 23.12.2024 t'i paraqesin propozimet e tyre lidhur me çdo kundërshtim të provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të KPP-së dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës në pajtim me nenin 244 par.1 të KPP-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë ende nuk ka pranuar nga gjykata kërkesën për hudhje të aktakuzës apo kundërshtim të provave të parashtruar nga pala e pandehur apo i autorizuari i tij.

Duke analizuar rastin, po ashtu rrjedhën e veprimeve në këtë çështje penale si dhe rrethanat objektive të rastit, Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë që të iniciohen hetime disiplinore ndaj Prokurores D.H, pasi që në këtë rast veprimet e prokurores së lartcekur nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurores D.H lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/I.nr...

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 05.12.2024, kemi pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar në lëndën PP./I.nr., av.B.A, përmes së cilës kërkesë i njëjti pretendon se prokurorja D.H ka kryer shkelje disiplinore në atë mënyrë që, në seancën e shqyrtimit fillestar, ku pjesëmarrës ishin prokurorja F.C, i dëmtuari A.TH me të autorizuarin av.B.A, si dhe i akuzuari Y.B me mbrojtësin av.F.K, ku gjyqtarja ishte informuar nga palët se nuk janë pajisur me shkresat e lëndës, me ç'rast gjykata kishte marrë aktvendim me të cilin kishte obliguar prokurorinë që në afat prej tre (3) ditësh të pajisë me të gjitha shkresat e lëndës palën e pandehur me mbrojtësin e tij si dhe palën e dëmtuar me të autorizuarin e tij, ku sipas palës ankuese, i njëjti ishte paraqitur për të marrë shkresat e lëndës në zyrën e prokurores D.H ditën kur edhe është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar e po ashtu edhe më datë 28.11.2024, ndërkaq edhe përkundër kësaj prokurorja nuk e ka përmbushë detyrimin brenda afatit gjyqësor si dhe në vend që t'i dorëzoj shkresat e lëndës të autorizuarit të palës së dëmtuar, sipas tij prokurorja D.H është tallur duke thënë se duhet sjellë autorizimin paraprakisht. Pala ankuese tutje pretendon se prokurorja D.H nuk e ka përmbushë detyrimin e saj edhe pse ka filluar të rrjedhë afati për paraqitjen e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, rrjedhimisht edhe mbrojtja e tyre për të kundërshtuar një kërkesë të tillë.

Deklarimet e Prokurores D.H në raportin me shkrim të dorëzuar më datë 06.12.2024

Prokurorja D.H, në raportin e saj me shkrim të dorëzuar në zyrën e Kryeprokurorit më datë 06.12.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *Lidhur me lëndën PP.I.Nr..., kemi ngritur Aktakuzë me datë 24.01.2024. Me datë 22.11.2024 është thirrur seancë fillestare për këtë lëndë. Megjithatë në datën 22.11.2024 kam pasur të caktuara 5 seanca gjyqësore, në lëndën PP.I.nr.. e cila ka qenë seancë fillestare ka prezantuar në zëvendësim prokurori tjetër. Në të njëjtën javë kemi qenë edhe kujdestar dhe kemi pasur angazhime lidhur me lëndë edhe pas përfundimit të kujdestarisë të cilat kanë qenë të natyrës urgjente me paraburgim. Siç është cekur edhe në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të Gjykatës Themelore Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.. të datës 22.11.2024, në çështjen penale kundër të pandehurit Y.B për veprën penale në Bashkëkryerje me NN persona Vjedhje grabitqare nga neni 316 par 2 lidhur me par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, përfaqësuesi i të dëmtuarit avokati B.A në procesverbalin e shqyrtimit fillestar deklaroi se nuk është pajisur me shkresa të lëndës pasi është angazhuar po atë ditë në këtë çështje penale dhe Prokuroria nuk ka mundur të jetë në dijeni se është angazhuar. Me këtë vërtetohet se avokati B.A nuk ka paraqitur autorizim se është përfaqësues i autorizuar i palës së dëmtuar A.TH, në Prokurori lidhur me këtë çështje penale. Lidhur me këtë av.B.A ka qenë në zyrë në orët e pasdites, dhe i njëjti na ka treguar për çështjen, për të cilën është pyetur se a ka pasur autorizim për këtë lëndë me qëllim që të shihet se a ka pasur ndonjë Kërkesë apo autorizim në mënyrë që të pajiset me shkresat e lëndës. I njëjti në Prokurori nuk ka prezantuar autorizim dhe as kërkesë me shkrim për pajisje me shkresa të lëndës në këtë çështje. I njëjti ka njoftuar verbalisht se është angazhuar në Gjykatë dhe se i ka kërkuar shkresat e lëndës siç shihet edhe nga Procesverbali i shqyrtimit fillestar, i cekur më lartë i dt.22.11.2024. Sa i përket datës 28.11.2024 e cila është cekur në kërkesën e avokatit B.A atë ditë ka qenë festë dhe nuk ka mundur të jetë as dita e fundit e ndonjë afati. Pyetja drejtuar avokatit B.A lidhur me atë se a posedon autorizim për çështjen penale për të cilën ka kërkuar shkresat e lëndës konsiderojmë se nuk është tallje, duke parë se i njëjti nuk ka paraqitur as autorizim as kërkesë me shkrim për pajisje me shkresa të lëndës. Në momentin që e kemi parë procesverbalin e shqyrtimit fillestar të njëjtit*

i është thënë se shkresat do të fotokopjohen sa më parë dhe që të vijë të pajiset me shkresat e lëndës në ditën vijuese të punës. Aty për aty në ditën të cilën avokati B.A ka qenë në zyrën time e cila ka qenë ditë pune, në prezencën e zyrtarit ligjor V.J dhe bashkëpunëtores profesionale B.Z, i njëjti është njoftuar se meqenëse është vonë, të vijë të nesërmen që të pajiset me shkresat e lëndës. Shkresat e lëndës janë bërë gati në ditën vijuese të punës. Në momentin që kemi pranuar këtë kërkesë, aty për aty menjëherë edhe stafit të zyrës tuaj i janë prezantuar kopjet e shkresave të lëndës PP.I.nr..., çka dëshmon se të njëjtat kanë qenë të gatshme paraprakisht për pajisje të avokatit B.A. Avokati B.A ka thënë që do të vijë të pajiset me shkresa të lëndës, dhe i njëjti nuk ka ardhur për tu pajisur me shkresa të lëndës. Pas kësaj avokati B.A nga zyra ime është ftuar edhe përmes telefonit zyrtar të zyrës për të ardhur që të pajisjet me shkresa të lëndës, mirëpo avokati B.A në bisedë në telefon ka deklaruar se nuk mund të vijë ti marrë shkresat e lëndës pasi do të udhëtojë për në Gjermani. Pas kësaj të njëjtit i është thënë që të dërgoje eventualisht ndonjë zëvendësues për ti marrë shkresat e lëndës. I njëjti ende nuk ka ardhur për ti marrë shkresat e lëndës edhe pse të njëjtat i ka të gatshme, të gjitha në kopje fizike. Gjithashtu theksojmë se lidhur me veprimet juridike i njëjti nuk ka humbur asnjë afat për asnjë veprim procedural. Andaj duke u bazuar në këto që u thanë më lartë, asnjë nga pretendimet e paraqitura nga avokati B.A në Kërkesën e tij lidhur me këtë çështje penale ndaj meje si prokuror i çështjes nuk qëndrojnë dhe janë plotësisht të pabazuara.

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se prokurorja D.H nuk ka kryer shkelje disiplinore të sanksionuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, edhe përkundër pretendimeve ankimore të paraqitura nga pala ankuese, përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit Av.B.A, mbi bazën e së cilës është hapur ky rast disiplinor, se prokurorja e çështjes ka shkelur detyrat e saj zyrtare si prokurore dhe në mënyrë të vazhdueshme nuk ka ndërmarrë veprimin prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi dhe nuk ka ushtruar funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj, edhe pse ka filluar të rrjedhë afati për paraqitjen e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, rrjedhimisht përgatitja e palës së dëmtuar në kundërshtimin e një kërkesë të tillë.

Autoriteti Kompetent ka ardhur deri te ky përfundim për faktin se i dëmtuari si dhe parashtuesi i kësaj kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore, av.B.A pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë nuk kanë deponuar asnjë autorizim, përmes së cilit prokurorja e çështjes do të ishte vënë në dijeni për faktin se i dëmtuari ka avokatin në fjalë përfaqësues të autorizuar. Ndërkaq, në procesverbalin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 22.11.2024, gjykata ndër të tjera ka konstatuar prezencën e të dëmtuarit A.TH me përfaqësuesin av.B.A, por që në këtë seancë nuk ka prezantuar prokurorja D.H, për shkak se në të njëjtën ditë kishte për të prezantuar edhe në katër seanca të tjera, e që e njëjta nuk ka qenë e njoftuar për një autorizim të tillë të dhënë verbalisht në seancën fillestare. Sidoqoftë, pas vënies në dijeni të prokurores së çështjes se av.B.A është autorizuar nga pala e dëmtuar A.TH gjatë seancës të shqyrtimit fillestar, i njëjti menjëherë është thirrur për të ardhur t'i marrë shkresat e lëndës.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese se për shkak se nuk janë pajisur me shkresa të lëndës, si palë e dëmtuar rrezikojnë kalimin e afatit për kundërshtimin e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, i cili pretendim nuk qëndron për faktin se përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të dt. 22.11.2024, i pandehuri është njoftuar

mbi të drejtën e tij që të paraqesë çdo kundërshtim të provave të cekura në aktakuzë si dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës në pajtim me nenin 243 dhe 244 të KPP-së, dhe atë deri më datë 23.12.2024, ndërkaj Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në nenin 243 par. 1 ka përcaktuar vetëm prokurorin e shtetit si person të autorizuar në dhënien e përgjigjes ndaj kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës të paraqitur nga ana e palës së akuzuar apo mbrojtësit të tij.

Sidoqoftë, pala e dëmtuar ka të drejtë që të paraqesë ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës në vendimin sa i përket kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave dhe atë brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim. E ritheksojmë se pala e akuzuar është ende brenda afatit ligjor dhe atë deri më datë 23.12.2024 për të paraqitur kërkesën për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, e që Prokuroria Themelore në Prishtinë edhe deri më sot nuk ka pranuar kërkesën dhe kundërshtimin e tillë nga ana e gjykatës, andaj nuk ekziston mundësia që palës së dëmtuar të i humbë afati për ankimim sa i përket vendimit të gjykatës i cili ende nuk është nxjerrë, mbi një kërkesë dhe kundërshtim që ende nuk është parashtruar dhe ende ka afat ligjor për parashtrim.

Duhet theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese se është paraqitur në zyrën e prokurores D.H më datë 28.11.2024, kjo për faktin se për datën të cilën i referohet pala ankuese, dt.28.11.2024 (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë), është ditë pushimi në institucionet publike, andaj edhe është e pamundur që pala ankuese të jetë paraqitur me atë datë në Prokurori për të kërkuar shkresat e lëndës.

Sidoqoftë, si Autoritet Kompetent kemi vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit, kemi vlerësuar faktin nëse vonesa e prokurores D.H në dhënien e shkresave të lëndës për përfaqësuesin e palës së dëmtuar ka sjellë pasoja të rënda për palën e dëmtuar dhe kemi ardhur në përfundim se për palën e dëmtuar nuk është shkaktuar ndonjë dëm i pariparueshëm si dhe nuk ka ndikuar negativisht në të drejtën e tij për akses në drejtësi. Mosveprimi i prokurores D.H është si rezultat i rrethanave objektive, faktit se prokurorja në po të njëjtën ditë kur është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ka pasur edhe katër seanca të tjera, andaj nuk ka mundur të prezantojë e rrjedhimisht nuk ka qenë në dijeni për autorizimin e dhënë nga pala e dëmtuar për av.B.A, gjithashtu shtu këtu faktin se prokurorja në fjalë ka qenë e mbingarkuar me çështje të tjera të rëndësishme dhe urgjente çka ka sjellë në vonesën në dorëzimin e shkresave të lëndës, gjithmonë duke pasur parasysh se e njëjta, ka qenë e ngarkuar me kujdestari, respektivisht nga data 18.11.2024 deri më datë 24.11.2024. Kjo situatë dhe këto rrethana nuk tregojnë mosrespektim të detyrave, por një vështirësi objektive në përmbushjen e tyre, shtu këtu faktin se vonesa e tillë nuk ka shkaktuar pasoja për të dëmtuarin si dhe dështim në ushtrimin e të drejtave të tij ligjore brenda afateve të përcaktuara me ligj, andaj vonesa në pajisjen me shkresa të lëndës të palës së dëmtuar në rastin konkret, nuk përbën bazë për fillimin e hetimeve disiplinore kundër prokurores D.H.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se pretendimet e deklaruara në Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nuk paraqesin shkelje disiplinore, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar që veprimet apo mosveprimet e prokurores D.H paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT KRYEPROKURORI



Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës